



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), duke u mbështetur në nenin 30, nënparagrafi 30.5 të Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë

V E N D I M

PËR TRANSFERIMIN E KATËRMBËDHJETË PRESJE KATËRDHJETË E TETË PËR QIND (14,48 %) TË NJË NDARJE BUXHETORE NË NJË NDARJE TJETËR TË KOMUNËS SË PRISHTINËS GJATË VITIT FISKAL 2023

1. **MIRATOHET** Vendimi për transferimin e katërmëdhjetë presje katërdhjetë e tetë për qind (14,48%) të vlerës nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e subvencioneve të buxhetit të Komunës së Prishtinës gjatë vitit fiskal 2023.
2. Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është në vlerë 5, 850.000, 00 € (pesë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë euro), të cilat merren nga projektet e porealizuara të financuara nga granti qeveritar, si dhe nga të hyrat vetanake (shih: Shtojcën 1 Tabelën e buxhetit me kodet përkatëse buxhetore). Mjetet financiare të përcaktuara në këtë nen transferohen nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e subvencioneve.
3. Shuma e mjeteve të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, në vlerë 5, 850.000, 00 € (pesë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë euro), Komuna e Prishtinës nga kategoria e subvencioneve ia ndan:
 - 3.1 Ndërmarrjes publike lokale "TERMOKOS", SHA, vlerën prej 5, 000, 000 € (pesë milionë euro) me qëllim të realizimit të projektit për zgjerimin e rrjetit të Termokosit, sipas projektit të bashkëngjitur me këtë vendim (shih: Shtojca 2 Kërkesa e Termokosit nr. 2026 e datës 12.10.2023);
 - 3.2 Kompanisë regjionale e mbeturinave "PASTRIMI", SHA, vlerën prej 850, 000 € (tetëqind e pesëdhjetë mijë euro), prej të cilave 500, 000 € (pesëqind mijë euro) me qëllim të shlyerjes së borxhit për pagesën e tarifës së deponisë së mbeturinave, e cila është në kuadër të pjesës së aksioneve të Komunës së Prishtinës, si dhe 350, 000 € (treqind e pesëdhjetë mijë euro) për blerjen

e mjeteve teknike (shih: Shtojca 3 Kërkesa e datës 31.10.2023, si dhe e datës 01.11.2023 e kompanisë regjionale të mbeturinave "PASTRIMI", SHA).

4. Obligohet ndërmarrja publike lokale "TERMOKOS", SHA, që subvencionin e pranuar nga Komuna e Prishtinës ta realizojë për interesin publik sipas kërkesës dhe projektit për zgjerimin e rrjetit, sipas pikës 3, paragrafi 3.1 të këtij vendimi, dhe t'i dërgojë raport me shkrim Komunës së Prishtinës për shpenzimin e këtyre mjeteve.
5. Obligohet kompania regjionale e mbeturinave "PASTRIMI", SHA, që subvencionin e pranuar nga Komuna e Prishtinës ta realizojë për interesin publik sipas kërkesës për shlyerjen e borxhit për deponinë e mbeturinave, e cila është në kuadër të pjesës së aksioneve të Komunës së Prishtinës, si dhe 350,000 € (treqind e pesëdhjetë mijë euro) për blerjen e mjeteve teknike (kamionëve) sipas pikës 3, paragrafi 3.2 të këtij vendimi, dhe t'i dërgojë raport me shkrim Komunës së Prishtinës për shpenzimin e këtyre mjeteve.
6. Shtojcat e përcaktuara në këtë vendim konsiderohen pjesë përbërëse të këtij vendimi. Të njëjtat duhet të vulosen dhe të nënshkruhen nga Kryesuesi i Kuvendit. Shtojcat e këtij vendimi janë si në vijim:
 - Shtojca 1 Tabela e buxhetit me kodet përkatëse buxhetore,
 - Shtojca 2 Kërkesa e Termokosit nr. 2026, dt. 12.10.2023,
 - Shtojca 3 Kërkesa e datës 31.10.2023, si dhe e datës 01.11.2023 e kompanisë regjionale të mbeturinave "PASTRIMI", SHA.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtorja e Financave.
8. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/01-215584/23, më 03.11.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajçinovci

